



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
DREJTORIA E HARTIMIT TE PROJEKTEVE, MONITORIMIT TE INVESTIMEVE DHE
SHERBIMEVE

Nr. ____ Prot.

Patos më, __/__/2022

MIRATOHET:
KRYETARE
Rajmonda BALILAJ

DETYRE PROJEKTIMI

Objekti: Rikonstruksion i rrugës Unazë- Varreza pikë takimi rruga Dhori Tanaka

Vendndodhja: Bashkia Patos

Investitori: Bashkia Patos

Gjendja e Objektivit

Objekti për të cilin hartohet kjo detyrë projektimi ndodhet në pjesën Veri lindore të qytetit të Patosit dhe është segmenti që lidh rrugën e varrezave Dukas me rrugën Dhori Tanaka. Objekti ka një shtrirje në terren kodrimor dhe përshkon lagjen Dukas- Conan. Gjatesia e këtij segmenti është rreth 780 m. Aktualisht rruga është e demtuar dhe në periudhën e dimrit krijon shumë problem për banorët e kësaj lagjeje.

Kjo zonë është zhvilluar në mënyrë spontane pas viteve 1990. Segment rrugor I marrë në shqyrtim përdoret nga rreth 600 banorë të zonës që e përdorin për këtë rrugë si një rrugë lidhëse midis banesave të tyre dhe qytetit të Patosit. Aktualisht gjithë segmenti i rrugës ka një shtresë me cakull e cila është tejet e amortizuar. Për mirëmbajtjen e kësaj rruge, përgjatë viteve, kanë investuar vetë banorët e lagjes por këto investime kanë qenë të pjesshme dhe kryesisht përpara hyrjeve të banesave të tyre. Problematike nëselet infrastruktura inxhinierike e dobët, mungesa e trotuareve dhe rjetit të kanalizimeve të ujërave të zeza, ndricimit. etj që kërkojnë ndërhyrjen e planifikuar në këtë segment rrugor.

Qëllimi i Projektit

Qëllimi i projektit është përmirësimi i infrastrukturës së zonës, lidhja e kesaj lagjeje me pjesen tjetër të qytetit të Patosit, duke sjelle lehtësi për banorët e zonës që përdorin këto rrugë dhe ndertimi i rrjetit të kanalizimeve të ujërave të zeza (KUZ).

Objektivat:

1. Përmirësim dhe zgjidhje përfundimtare e aksesit dhe rrugës që lidh këto pjesë të lagjes Dukas-Coban me pjesen tjetër të qytetit të Patosit
2. Lehtësi në lëvizje e njerezve dhe përmirësim i infrastrukturës për lagjen

Detyrat që duhet të zgjidhet projekti

1. Rehabilitim i trupit të rrugës dhe pajisjen me paketën e nevojshme të shtresave rrugore.
2. Ndertim i rrjetit të kanalizimit të ujërave të zeza (KUZ).
3. Rehabilitimin e sistemit të kullës ekzistues, pastrimin e kanaleve dhe betonimin e kuletave përgjatë segmenteve të caktuar të rrugës.
4. Ndertimin e bankinave në të dyja anët e rrugës.
5. Preventivi të bëhet me çmimet manuale në fuqi dhe duke u shoqëruar me analizat për zerrat e punimeve që nuk janë parashikuar në manualin e miratuar.

Konceptoi:

Ing. Agim LISI

**DREJTORIA E HARTIMIT TË PROJEKTEVE, MONITORIMIT TË INVESTIMEVE
DHE SHËRBIMEVE**

Arben Manoku

Drejtor